



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KACANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

19.12.23	Vendi	10484110
001	Numri	370/01-82670
	Shtojcë	

KONTRATA PËR PUNË

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Shefket Koxha – Menaxher i prokurimit**; në njërën anë dhe

NTSH "AR DRITI" nga Ferizaji (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga i autorizuari **Nehat Dalloshi** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

"Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit"

me numër Identifikues **KA652/23-13486-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të **"Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit"**

1.2 Kontrata hynë në fuqi **19.12.2023**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **7 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **Varrezat e qytetit Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë **LPP-04/L-042**. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **9,500.00 €; me fjalë (Nantmijëepesëqindeuro e 00 centë.)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të punëve nga na e menagjerit të projektit si dhe komisionit për pranim të punëve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 00 muaj, pas pranimit të **punëve**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal

që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërrprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.



E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.


Për Operatorin Ekonomik




Për Autoritetin Kontraktues


Emri:	Nehat Dalloshi	Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Pronar	Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:	<i>N. Dalloshi</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	19.12.2023	Data:	19.12.2023
Vula:		Vula:	



PARAMASA DHE PARALLOGARIA						
DEKORIMI I QYTETIT ME DRITA DEKORATIVE DHE BREDHIT-2023						
Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Foto	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total me TVSH
1	Furnizimi montimi dhe mirëmbajtja e portave hyrëse me formë të yllit me ngjyra të verdhë dekoruese sipas fotos me dimensione (4x4x4m). Një të vendoset në fillim të shetitorës dhe një të vendoset në fund, dekorimi duhet të jetë i njëjtë me atë në foton e bashkangjitur. <u>Vërejtje:</u> <u>Porta hyrëse në formë të yllit duhet të jetë i punuar me drita ngjyrë të verdhë .Duhet të rrethohet me çyp ndriçues LED llampa 230V .Kabëll prej gome në 10 m duhet të jenë 100 llampa LED ku ado e 10 dritë të jetë me blis me mbrojtje IP44.</u>					
2	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e dritave dekoruese, ngjyrë të verdhë të ngrohtë. Do të mbulojnë pjesën kryesore në mas të pemëve dhe shyllave të ndriçimit publik ku distanca në mes të ndriçuesëve të jetë 30-40cm. <u>Vërejtje:</u> <u>Te respektohen specifikacionet e cekura më lartë.</u>		copë	1	1,500.00 €	1,500.00 €
3	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e dritave dekoruese, ngjyrë të verdhë të ngrohtë. Këto drita do të vendosen dhe do të mbështjellen përrreth degeve kryesore të pemëve sipas fotos.		m'	4500	0.80 €	3,600.00 €
			m'	1700	0.80 €	




4	Furnizimi, montimi i portave me drita si dhe mirëmbajtja e dritave dekoruese me formë si në foto, për vendosje nga shtylla në shtyllë sipas fotos. <u>Vërejtje:</u> <u>Të jenë me rrietë ndriçuese ≥220V . LED llambat. blic dhe me mbrojtje IP44. Duhet të varen me litare metalik ne pozite horizontale.</u> <u>Najyra e verdhë e ngrohtë.</u>		copë	4	200.00 €	800.00 €
6	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e harpave dekoruese-ndriçues me ngjyrë të ngrohtë të verdhë dhe të bardh me dimensione 55x150 cm. <u>Vërejtje:</u> <u>Duhet të jenë me konstruktion metalik. Të mbulohet me rrietë ndriçuese ≥220V me kablo prej qome. LED llambat duhet të jenë në rrietë. blic dhe me mbrojtje IP44. Duhet të përförcohen me sajila speciale.</u>					
7	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e yllit dekoruese-ndriçues me ngjyrë të ngrohtë të verdhë dhe të bardh me dimensione 55x150 cm. <u>Vërejtje:</u> <u>Duhet të jenë me konstruktion metalik. Të mbulohet me rrietë ndriçuese ≥220V me kablo prej qome. LED llambat duhet të jenë në rrietë. blic dhe me mbrojtje IP44. Duhet të përförcohen me sajila speciale.</u>		copë	25	20.00 €	500.00 €



8	Llogaritja totale e montimit të gjitha pozicioneve me kablo në ndriçimin publik ekzistues.				
Vërejtje: <i>Cdo dëmtim eventual i ndriçimit publik duhet të kthehet në qendrien e mëparshme në afat shumë të shkurtër kohor (kablo, kapak të shtyllave, shturesa dhe të gjitha materialet përcelëse).</i>					
9	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike me gjatësi 3.5m dhe prerje tërthore 60x60x3 mm, duke përfshirë montimin dhe ankerimin e tyre në murin me gurë, për mbajtjen e sajllëve për vendosjen e ndriçimit dekorues. Në këtë pozicion hyjnë edhe furnizimi dhe montimi i sajllëve të çelikut në drejtim gjatësorë (1000m) dhe tërthorë në të cilat do të montohet ndriçimi dekorues.				
		copë	1	945.00 €	945.00 €
		copë	42	10.00 €	420.00 €
Totali:					9,500.00 €

Verejtje: Pas përfundimit të festave, punekryesi duhet të beje demontimin e të gjitha instalimeve, me transport deri në lokacionin që e cakton Menaxheri i Projektit.



Punoi:
DSHPE

Dullati